



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 361

Datë: 11.08.2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40, paragrafi 2 shkronja (d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28/15, qershor 2008”, bazuar në nenin 10, nenin 19, nenin 29 paragrafi 1 pika (a), të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 09.08.2022 merr këtë:

V E N D I M



PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË KOMITETIT PËR FAMILJE TË DËSHMORËVE
INVALID VETERANË TË LUFTËS SË UÇK-SË SI DHE MARTIRË TË LUFTËS PËR VITIN
2022

1. Miratohet Plani i veprimit Nr.02/324 datë: 12.07.2022 i Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të luftës së UÇK-së, si dhe të Martirë të luftës në Komunën e Malishevës për vitin 2022.
2. Plani i veprimit për vitin 2022, përfshinë gjithë punën dhe aktivitetet e përcaktuara nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të luftës së UÇK-së, si dhe të Martirë të luftës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i veprimit për vitin 2022.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kuvendi i Komunës, përmes Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të luftës së UÇK-së, si dhe të Martirë të luftës.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Drejtorive të KK-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi





PROJIMAR ME: 12-07-2022
ACCEPTED ON:
PRILJENO:
Nr.No.Bi: 02/324

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO /
KOMUNA MALISHEVË/ OPŠTINA MALIŠEVO/ MUNICIPALITY OF MALISHEVË

KOMITETI PËR FAMILJE TË DËSHMOREVE, INVALIDË, VETERANË TË LUFTËS SË UÇK-SË SI DHE MARTIRË TË
LUFTËS

PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2022 TË FDIVLUÇKML

Në mbledhjen e Tretë të mbajtur më datë 12.07.2022 Komiteti për Familje të Dëshmoreve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës diskutoi për hartimin e Planit të Veprimit të këtij Komiteti.

Plani i Veprimit do të jetë Platforma e Komitetit, i cili duhet ta përmbushet në përpikmëri në faza të caktuara kohore.

Komiteti FDIVLUÇKML është themeluar nga Asambleja Komunale e Malishevës, me qëllim ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Komiteti do të bëjë përpjekje të vazhdueshme që veprimtarinë e vet ta zhvilloj në bazë të këtij Plani.

Plan Veprimi i prezantuar më poshtë është njëkohësisht edhe Statuti i Komitetit FDIVLUÇKML.

Më poshtë prezantojmë Planin e Veprimit të Komitetit për Familje të Dëshmoreve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës.

Objektivat	Aktivitetet	Treguesit e verifikueshëm	Rreziqet dhe supozimet	Koha e implementimit të objektivit	Komente
Hartimi dhe shqyrtimi i draft planit të punës për vitin 2022 dhe miratimi i tij	Takim me të gjithë anëtarët e Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës me qëllim të hartimit dhe shqyrtimit të planit të punës si dhe arritja e pajtueshmërisë për orarin e takimeve për vitin 2022. Gjatë fazës së parë, për të hartuar planin, komiteti do të konsultojë shoqatat e dala nga lufta.	Hartimi i draftit të planit të punës. Plani i punës për vitin 2022.	Mos-thirrja e takimit; Mos-gatishmëria e anëtarëve të komitetit për t'u angazhuar në hartimin e planit të veprimit.	Propozimet, vërejtjet, plotësimet si dhe miratimi i Planit për vitin 2022 duhet të kryhet deri në fund të dhjetor 2022.	Të gjithë anëtarët e Komitetit kanë të drejtë të propozojnë çështje të caktuara, të cilat duhet të analizohen para se të merret vendimi që ato propozime të futen në këtë plan.
Përcjellja dhe shqyrtimi i rregullt i punës dhe veprimeve të organeve komunale	- Shqyrtimi i pajtueshmërisë së të gjitha akteve normative, politikave, praktikave të kuvendit komunal të cilat i shërbejnë mbrojtjes së Vlerave të Luftës së UÇK-së. - Komiteti duhet të ngrejë çështje përkitazi me Vlerat e Luftës.	Mbajtja e mbledhjeve të rregullta (së paku 6) të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së.	Mos thirrja e mbledhjeve të rregullta; Anulimi i mbledhjeve; Ne vitin e pare sfid është vonesa e	Janar - Dhjetor 2022	Përveç shqyrtimit të procesverbaleve, Komiteti do të bëjë shqyrtimin e çdo aktiviteti të bërë në komunën e Malishevës që ndërlihen me

Përcjellja e punës së organeve komunale	- Sa herë që Kuvendi Komunal ka në rend të ditës çështje që ndërlidhen me veprimtarinë e Komitetit, një nga anëtarët e Komitetit duhet të marrë pjesë në seancën dëgjimore të Kuvendit Komunal. - Komiteti të adresojë kërkesa drejtuar Asamblesë Komunale, Kryetarit të Komunës, Drejtorive dhe Komitetit për Politikë dhe Financa.	së si dhe Martirë të Luftës. Komiteti duhet të shqyrtojë aktet normative të Kuvendit Komunal që kanë të bëjnë me veprimtarinë e komitetit. Numri i çështjeve dhe rekomandimeve të përgatitura dhe të adresuara tek organet relevante.	themelimit të këtij komiteti. Mungesa e kuorumit; Mos gadishmëria e anëtarëve të Komitetit të Vlerave të Luftës që t'i ngrisin çështjet tek organet komunale. Ënjorimi i rekomandimeve dhe kërkesave të Komitetit nga Organet Ekzekutive, si dhe nga Asambleja Komunale.	Janar – dhjetor 2022	fushëveprimtarinë e Komitetit. Që puna e Komitetit të jetë efikase, nevojitet një bashkëpunim i vazhdueshëm me organet komunale.

Adresimi i kërkesave dhe rekomandimeve	Për çështje që ndërlidhen me veprimtarinë e Komitetit, ky i fundit duhet të hartojë rekomandime, kërkesa dhe ankesa drejtuar organeve komunale.	Numri i çështjeve të përgatitura dhe të adresuara tek organet komunale	Shpërfillja nga drejtoritë komunale.	Mars – Dhjetor 2022	Komiteti, në prag të festave kombëtare do të kërkojë nga drejtoritë përkatëse që të ndajnë ndihma materiale për ndonjë familje të Dëshmorëve, Invalidihëve dhe Martirëve të Luftës.
Pjesëmarrje në Akademi	Komiteti FDIVL UÇKML duhet të jetë pjesëmarrës drejtëpërdrejtë në Akademitë Përkujtimore të Dëshmorëve dhe Martirëve të Luftës së UÇK-së të Komunës së Malishevës. Një anëtar i Komitetit të përfaqësohet në Këshillin Organizativ për shënimin e Akademitë Përkujtimore apo të një organizimi të ngjashëm.	Numri i akademive përkujtimore; Numri i vizitave në teren; Lista e problemeve të identifikuara...	Shpërfillja e Drejtorisë së Kulturës që mund t'i bëhet Komitetit për organizimin e Festave Kombëtare; Mungesa e interesimit të anëtarëve të komitetit për kryerje të vizitave në Akademitë Përkujtimore.	Janar – dhjetor 2022	Bashkëpunim i ngushtë me familjet e dëshmorëve dhe kategorive tjera të dala nga lufta. Një bashkëpunim i mirë mes Komitetit dhe Drejtorisë së Kulturës, si dhe me Shoqatat e dala nga Lufta e UÇK-së është çështje emidiare e Komitetit në

	Komiteti FDIVLUÇKML duhet të marrë pjesë në ceromonitë mortore të Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së.		Mungesa e mjeteve financiare.		realizimin e objektivave.
	Komiteti FDIVLUÇKML duhet të jetë pjesë e organizimit të Festave me karakter kombëtar, siç janë: 17 Shkurti, 5 – 7 Marsi (Epopeja e UÇK), 16 Qershori, 28 Nëntori dhe 30 Dhjetori dhe 26 prill 1998 Beteja e parë në Balincë. Një anëtar i Komitetit të përfaqësohet në Këshillin Organizativ për shënimin e Akademisë Përkujtimore apo të një organizimi të ngjashëm.				
	Komiteti FDIVLUÇKML të organizojë ndarjen e <i>Mirënjohjes</i> në emër të				

	Komititeti. Mirënjohja t'i ndahet të gjithë Dëshmorëve, Martirëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së të komunës së Malishevës. Po ashtu, me <i>Mirënjohje</i> të nderohen edhe ata individë që kultivojnë Vlerat e Luftës së UÇK-së. ● Komiteti FDIVL UÇKML gjatë festave të ndryshme t'i bëjë vizitë familjeve të Dëshmorëve, Martirëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së të Komunës së Malishevës. Dhe brenda mundësive t'i ofrojë ndihmë atyre familjeve me nevojë. ● Të gjitha shtëpitë që u ndërtohen veteranëve me donacione dhe përmes komunës të njoftohet edhe				
--	---	--	--	--	--

	Komiteti për kategoritë e dala nga lufta.				
Krijimi i databazës me të gjitha datat historike të Komunës së Malishevës	• Data e rënies së Dëshmorëve dhe një histori e shkurtër për se cilin dëshmor të Komunës së Malishevës. • Data e vrasjes së Martirëve dhe një histori e shkurtër për se cilin martir të Komunës së Malishevës. • Data e Masakrave në Komunën e Malishevës dhe një histori e shkurtër për masakrën në fjalë. • Shënimi i datave me rëndësi të betejave të zhvilluara nga Njësitet e UÇK-së që kanë	Listimi kronologjik i datave historike;	Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Komitetit dhe Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së.	Mars – qershor 2021	Për realizimin e objektivit për krijimin e databazës me datat historike, kërkohet bashkëpunim i ngushtë ndërmjet Komitetit dhe Shoqatave të Luftës.

	vepruar në komunën e Malishevës.				
Muzeu i Qytetit të Malishevës	- Komiteti FDIVLUÇKML ta ndihmoj menaxhmentin e Muzeut të Qytetit në grumbullimin e artefakteve historike të periudhave të ndryshme, sidomos të Luftës së UÇK-së. - Bugjeti i Kuvendit Komunal parasheh edhe një shumë të financave (prej 20. 000 eurove) për renovim të Muzeut. Komiteti për mbrojtjen e Vlerave të Luftës në planin e tij parasheh angazhim në monitorimin e këtyre mjeteve.	Lista e gjësendeve historike të Luftës 1998 – 1999.	Mungesa e interesimit të menaxhmentit të Muzeut për të bashkëpunuar me Komitetin.	Shtator – nëntor 2022	Sektori i Luftës në Muzeun e Qytetit duhet të sistemohet sipas kategorisë së artefakteve.

	• Bratja e Muzeut të Luftës, nga objekti aktual tek objekti i ri i Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së afër varrezave të dëshmorëve në Malishevë.				
Organizimi i një Konference Vjetore	• Komiteti FDIVLUÇKML në Planin e tij parasheh edhe organizimin e një Konference Vjetore me titull “Lavdia e Luftës së UÇK-së”. Në Konferencë mund të marrin pjesë studiues të ndryshëm me kumtesa të Luftës së UÇK-së. Lidhur me Konferencën, Komiteti FDIVLUÇKML do të nxjerrë një rregullore të	Lista për ndarjen e Mirënjohjeve	Mungesa e financimit të Komitetit për organizimin e Konferencës Vjetore.	Qershor – dhjetor 2022	Nevoja e një Konference kushtuar Luftës së UÇK-së është e domosdoshme dhe e kërkuar nga familjet e dala nga lufta.

	posaçme.Komiteti FDIVLUÇKML në Planin e vet parasheh edhe realizimin e botimit të një reviste vjetore, në të cilën mund të përfshihen të gjitha kumtesat e dala nga Konferenca Vjetore, si dhe biografi të dëshmorëve dhe ngjarje tjera të Luftës së UÇK-së. • Komiteti FDIVLUÇKML të bëjë një listë të personave të zhdukur të Komunës së Malishevës në Luftën e viteve 1998 – 1999, si dhe të vizitorëve familjet e tyre. • Komiteti FDIVLUÇKML do të identifikojë lapidarët, shtatoret, bustet, dhe pllakat e ndryshme të Luftës së UÇK-së, si dhe të vizitorëve të gjitha ato për të parë gjendjen e tyre				
--	--	--	--	--	--

	fizike. Nëse ndonjë prej tyre është dëmtuar të intervenohet për restaurim.				
Takime me drejtorë të drejtorive	- Të ftohet zyrtari kryesor financiar që të raportojë për Komizën komunale buxhetore. - Të ftohet drejtori i drejtorisë së Kulturës që të raportojë për punën e kësaj drejtorie lidhur me shënimin e Festave Kombëtare dhe të shënimit të Akademive Përkujtimore.	Draft raporteve të drejtorive të dorëzohen tek anëtarët e komitetit.	Mosgadishmëria e drejtorëve për të raportuar para Komitetit.	Mars, qershor, nëntor 2022	
Mbledhjet e Komitetit	- Komiteti mban mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme. - Mbledhjet e rregullta duhet të mbahen së paku gjashtë të tilla	Mbledhjet janë zyrtare të karakterit zyrtar	Mungesa e korumit. Shtyerja e mbledhjeve	Shkurt – dhjetor 2022	Mbajtja e mbledhjeve të rregullta rrit efektshmërinë e punës së Komitetit, si dhe shton nevojën e

	brendna vitit kalendarik. Ato duhet të mbahen: 1) në shkurt, 2) në maj, 3) në qershor, 4) në gusht, 5) në nëntor dhe 6) në dhjetor. Mbledhjet e jashtëzakonshme mbahen sipas nevojës.				angazhimeve të nevojshme.
Përgatitja e raportit të punës për vitin 2022 dhe planit të punës për vitin 2023	Shqyrtimi, analizimi dhe aprovimi i raportit vjetor të punës së Komitetit për Vlerat e Luftës për vitin 2022	Draft raporti për vitin 2022	Mosgatishmëria e anëtarëve të komitetit për hartimin e raportit vjetor dhe planit të punës	Dhjetor 2022	Komiteti për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të Luftës së UÇK-së debaton lidhur me raportin e punës për vitin 2022.

Malishevë:

12.07.2022

ILAZ KRASNIQI, kryetar i Komitetit